



REPUBLIKA E KOSOVËS \* REPUBLIKA KOSOVA  
KOSOVA CUMHURIYETI  
Komuna e Prizrenit \* Opština Prizren  
Prizren Belediyesi  
Kryetari i Komunës / Predsednik Opštine  
Belediye Başkanı

01 Nr. 159/26 Dt. 08.04.2026



Republika e Kosovës  
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Komuna e Prizrenit  
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Në bazë të nenit 13 dhe 58 pika b të Ligjit nr. 03/L-040, për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 28/2008) nenit 1 paragrafi 2, nenit 3 paragrafi 2 dhe nenit 14 paragrafi 1 Rregullores Komunale nr. 001-011-201 datë 03.01.2024 për Kushtet, Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve, Transfereve dhe Granteve dhe nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit nr. 01/011-5643 të datës 15.10.2008, pas kërkesës 01-400 nr. 27699 datë 06.03.2026, të Aolta Bajramit, kryetari i Komunës, merr këtë:

### V E N D I M Për lejimin e mjeteve financiare

1. Miratohet kërkesa 01-400 nr. 27699 datë 06.03.2026 të Aolta Bajramit nga Prizreni, për lejimin e mjeteve financiare për mbulimin e shpenzimeve rreth pjesëmarrës dhe prezantimit në Konferencën Ndërkombëtare LEAPin Conference 2026, e cila do të mbahet me datë 18.04.2026 në ITP në Prizren, kështu që, për këtë qëllim dhe në emër të mbulimit të shpenzimeve rreth këtij prezantimi në këtë Konferencë, lejohen mjetet financiare në shumën prej 500,00 € (pesëqind euro).
2. Shuma e lejuar, e përshkruar si në pikën 1 të këtij Vendimi, do të sigurohet nga buxheti i Komunës—pozicioni i subvencioneve dhe transfereve i Zyrës së Kryetarit të Komunës.
3. Obligohet Drejtoria për Ekonomi dhe Financa për zbatimin e këtij vendimi.
4. Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e nënshkrimit të tij.

Kryetari i Komunës  
Shaqir Totaj



- Vendimi iu dërgohet:
- Drejtorisë së Ekonomisë dhe Financave,
  - Të lartcekurës,
  - Arkivës së Kryetarit.